



100 Vjet Pavarësi

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Ministri**

3723/  
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 02.07.2012

**URDHËR**

Nr. 276, datë 02.07.2012

**PËR**

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË**  
**“LABORANT MJEKËSOR” DHE “FIZIOTERAPI”; SI DHE HAPJEN E PROGRAMIT TË**  
**STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL NË “INFIERMIERISTIKË**  
**KLINIKE” NË SHKOLLËN E LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE “MEDIKADENT”**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; dhe të nenit 42/1 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.674, datë 27.9.2006 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Medikadent””:

**URDHËROJ:**


1. Hapjen, në përputhje me Vendimin nr. 333, datë 08.06.2012 të Këshillit të Akreditimit, në Shkollën e lartë universitare jopublike “Medikadent”, e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në
  - a. “Laborant mjekësor”,
  - b. “Fizioterapi”.
2. Hapjen, në përputhje me Vendimin nr. 333, datë 08.06.2012 të Këshillit të Akreditimit, në Shkollën e lartë universitare jopublike “Medikadent”, e programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional” në “Infermieristikë klinike”.



3. Programet e studimeve të ciklit të parë të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve studimi lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në:
  - a. “Laborant mjekësor”,
  - b. “Fizioterapi”.
4. Programet e studimit të ciklit të dytë të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1.5 vite akademike. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në “Infermieristikë klinike”.
5. Shkolla e lartë universitare jopublike “Medikadent”, të plotësojë dhe të dërgojë në MASH brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri, një raport për plotësimin e sugjerimeve të vëna nga Këshilli i Akreditimit në Vendimin nr. 333, datë 08.06.2012.
6. Programet e studimeve të fillojnë në vitin akademik 2011-2012.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Shkolla e lartë universitare jopublike “Medikadent”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJ



MINISTËR

